

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE - PRISHTINË



PUNIM MASTER

Mentori:
Prof. dr. Hysni Osmani

Kandidati:
Bach. Avni Kelmendi

Prishtinë, 2018

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE - PRISHTINË

DEPARTAMENTI I PRODHIMTARISË DHE AUTOMATIZIMIT

PUNIM MASTER

LËNDA: KONTROLI I BASHKËSIVE TË SALDUARA,

TEMA: ANALIZA E GABIMEVE NË BASHKËSINË E SALDUAR NGA
ÇELIKU PËR ENË NËN SHTYPJE

Mentori :
Prof. dr. Hysni Osmani

Kandidati :
Bach. Avni Kelmendi

Prishtinë, 2018

PËRMBAJTJA

1.0.	HYRJE.....	4
2.0	METODAT E SALDIMIT TË KONSTRUKSIONEVE nga çeliku për enë nën shtypje.....	5
2.1.	Saldimi me hark elektrik me dorë HED	5
2.1.1.	Pajisja dhe përdorimi i saldimit me hark elektrik me dorë	6
2.1.2.	Zgjedhja e materialit plotësues.....	7
2.1.3.	Teli për saldimit dhe regjenerim me gaz.....	8
2.1.4.	Elektrodat e mbështjella për saldimit me hark elektrik me dorë	8
2.2.	Saldimi me metodën MIG /MAG	9
2.2.1.	Saldimi me metodën MIG	9
2.3.	Saldimi me metodën MAG.....	10
2.4.	Saldimi me metodën TIG.....	11
3.0	Veçoritë e konstruksioneve nga çeliku për enë nën shtypje	12
3.1.	Karakteristika e materialit bazë dhe plotësues.....	12
3.2.	Përgatitja e detaleve për saldimit	19
4.0	FAKTORËT QË NDIKOJNË NË CILËSINË E KONSTRUKSIONEVE TË SALDUARA	20
4.1.	Faktorët për vlerësimin e saldueshmërisë.....	20
4.2.	Cilësia e tegelave të salduar.....	21
4.3.	Shënimi i tegelave	23
4.3.1.	Përgatitja e detaleve nga çeliku dhe shënimi i tegelave në konstruksionin e kaldajës	26
5.0.	KONTROLLI I CILËSISË SË KONSTRUKSIONEVE TË SALDUARA	30
5.1.	Metodat e kontrollit pa shkatërrim	32
5.1.1.	Konrolli Vizual	32
5.1.2.	Prova me rreze “X” (Rëntgen).....	33
5.1.3.	Prova me rreze gama	34
5.1.4.	Konrolli me ultratingull.....	36
5.1.5.	Metodat elektromagnetike.....	37
5.1.6.	Konrolli me penetrant (Lëng kapilar).....	38
5.2.	Gabimet në bashkësitë e salduara	40
5.2.1.	Plasaritjet	43
5.2.2.	Poret e gazit, zbrazëtite, flluskat e gazit-poroziteti	44
5.2.3.	Mbeturinat në gjendje të ngurtë	45

5.2.5. Gabimet e formës	47
5.2.6. Gabimet e tjera	49
5.3. Provat me shkatërrimi të bashkësive të salduara.....	51
5.3.1. Prova e tërheqjes	51
6.0. PJESA EKSPERIMENTALE	54
6.1. Përgatitja e kampionëve për saldim	54
6.2. Realizimi i saldimit të kampionëve	59
6.2.1. Realizimi i saldimit ballor pllakë-pllakë me metodën HED	60
6.2.2. Realizimi i saldimit këndor pllakë-pllakë me metodën HED	61
6.2.3. Realizimi i saldimit ballor pllakë - gyp me metodën MIG dhe HED.....	62
6.2.4. Realizimi i saldimit ballor pllakë - gyp me metodën MIG dhe HED.....	63
6.2.5. Realizimi i saldimit ballor pllakë - gypë me metodën HED	64
6.2.6. Realizimi i saldimit ballor gyp - gyp me metodën MIG dhe HED	65
6.2.7. Operacionet e përpunimit të kampioneve për provën në tërheqje	69
6.3. Matja e fortësisë me Aparati matës HARTIP 3000 Portable Metal HardnessTester	95
6.4. Prova e përkuljes.....	100
6.4.2. Paraqitjet gjatë provës në lakim në fytyrën e tegeli dhe në rrënjë	110
7.0. ANALIZA E REZULTATEVE TË FITUARA	111
8.0. Përfundim	112
Literatura	113
SHTOJCË	114

1.0. HYRJE

Kontrolli i materialeve dhe kontrolli i bashkësive të salduara ka historinë shekullor, dhe mund të thuhet se ato janë bërë qysh në kohën kur njeriu vendosi ti përdor materialet për saldim (bashkim).

Gabimet në bashkësitë e salduara janë të shoqëruara në saldimet e hershme në masë më të madhe, por gabimet sa vijnë e eliminohen në vazhdueshmëri me zhvillimet e mëtutjeshme të metodave të reja të saldimeve dhe të pajisjeve.

Gabimet janë identifikuar me metoda me të thjeshta në fillim kryesisht me prova me shkatërrim e pastaj janë zhvilluar në masë të paimagjinueshme dhe kryesisht përdoren kontrollet pa shkatërrim.

Për të realizuar një bashkësi të salduar mire nga çeliku për enën nën shtypje, është e domosdoshme të bëhen prova dhe kontrollë në kampionë të përgatitur apo edhe në bashkësinë e saluar.

Në këtë punim janë analizuar gabimet që shfaqen gjatë saldimit të produkteve nga çeliku për enë nën shtypje që realizohen në N.P.T."YLLITERM", e cila merret me prodhimin e kaldajave për ngrohje qendrore.

2.0 METODAT E SALDIMIT TË KONSTRUKSIONEVE NGA ÇELIKU PËR ENË NËN SHTYPJE

Teknologjia moderne e saldimit ka filluar vetëm pak para fundit të shekullit të 19-të me zhvillimin e metodave për gjenerimin e temperaturës së lartë në zonat e lokalizuara. Procesi i saldimit të konstruksioneve nga çeliku për enë nën shtypje, në përgjithësi kërkon një burim për ngrohje për të prodhuar temperaturë të lartë në një zonë të caktuar ku do të shkrihet materiali.

Ekzistojnë metoda të ndryshme dhe standarde të miratuara, dhe ende bëhen kërkime të vazhdueshme për metoda të reja si dhe për të përmirësuar metodat ekzistuese të saldimit. Si kërkesa për saldimin e materiale të reja dhe atyre me trashësi të mëdha janë rritja e komponentëve përkatësisht parametrave të regjimit të saldimit.

Metodat të cilat më së tepërmi përdoren për saldimin e çeliku për enë nën shtypje janë: saldimi me hark elektrik me dorë (HED), saldimi me hark elektrik nën mbrojtjen e gazit aktiv (MAG), saldimi me hark elektrik nën mbrojtjen e gazit inert (MIG), saldimi nën mbrojtjen e pluhurit (SNP), saldimi me gaz – me oksigjen dhe acetilen, saldimi me elektrodë të pa shkrijshme të volframit në mbrojtjen e gazit inert (TIG) dhe saldimi me elektroziztencë.

2.1. Saldimi me hark elektrik me dorë HED

Saldimi me HED është procesi më i vjetër, më i thjeshtë dhe me i gjithanshëm i saldimit. Zbulimi i tij është bërë në vitin 1900 nga A. P. Strohmenger dhe Oscar Kjellberg

mirëpökëtijzbulimi duhet theksuar se i paraprinë zbulimi i harkut të shkurtër elektrik nga Humphry Davy në vitin 1800 dhe zbulimi tjetër i harkut të vazhdueshëm elektrik nga Vasily Petrov në vitin 1802 dhe nga kjo kohë ka filluar një epokë e re e teknologjisë së saldimit. Harku elektrik formohet nga kontakti i elektrodës kundrejt detalit të cilin dëshirojmë ta saldojmë dhe duhet të cekim këtu se harku elektrik është shumë vështirë të mbahet në gjatësi të pandryshueshme gjatë saldimit çka na jep të kuptojmë se edhe tensioni ndryshon si rezultat i kësaj pasiqë siq e dimë tensioni është funksion i gjatësisë së harkut.

Elektrodat kanë formën e një shkopi me një gjatësi të caktuar të cilat janë të mbuluara me material (substancë) të cilat diktojnë në cilësinë e harkut dhe të tegelit.. Nxehtësia e krijuar si rezultat i harkut elektrik rezulton në shkrirje të pjesshme të elektrodës, mbështjellësit të saj dhe gjithashtu edhe materialit bazë ku pastaj këto komponentë së bashku formojnë tegelin. Mbështjellësi i elektrodës ka rol deoksidues dhe siguron mbrojtjen e materialit të shkrirë nga depërtimi i oksigjenit dhe nitrogenit në tegel që prania e tyre do të ishte e rrezikshme për tegelin për arsye se në bashkësinë e formuar do të paraqiteshin sforcime dhe defekte të natyrave të ndryshme. Elektrodat e përdorura tek kjo metodë janë të dedikuara për saldimitin e çeliqueve me përmbajtje të lartë karboni dhe lëgurave të tij, çeliqueve të që nuk ndryshken dhe disa materialeve që nuk kanë përmbajtjeje hekuri, gjithashtu kjo metodë ka një fushë të gjerë të aplikimit tek riparimi i detaleve.

2.1.1. Pajisja dhe përdorimi i saldimit me hark elektrik me dorë

Pajisjet për saldimit me hark elektrik me dorë janë të shumta por në përgjithësi parimi i punës së tyre është i njëjtë. Përveç aparateve që përdoren për saldimit patjetër duhet të kemi edhe pajisje mbrojtëse (personale dhe ato për mbrojtjen e rrethinës).

Pajisja për saldimit me hark elektrik me dorë me të cilën është realizuar saldimi i çelikut për enë nën shtypje është treguar në figurën 2.1.



Fig.2.1. Paisja për saldimit me hark elektrik me dorë

Saldimi me hark elektrik i konstruksioneve nga çeliku për enë nën shtypjemund të bëhet në të gjitha pozicionet, pra në pozicionin horizontal (H),vertikal (V), mbi kokë (MK) , etj ...




Fig.2.2.Pozicionet e saldimit konstruksioneve nga çeliku për enë nën shtypje

2.1.2.Zgjedhja e materialit plotësues

Pasi që të bëhet zgjedhja e materialit baze për prodhimin e bojlerëve duhet të mendohet dhe të bëhet zgjedhje e drejte për materialin plotësues pasi që edhe materiali plotësues luan një rol shumë të rëndësishëm pa të cilin nuk mund të paramendohet procesi i prodhimit, prandaj ky

material duhet ti plotësoj disa kritere apo disa veti te cilat duhet te jene përafërsisht te ngjashme me ato te materialit baze.

Ndër kriteret për zgjedhjen e materialit plotësuesjanë:

- Përbërja kimike e materialit plotësues,
- Veçorit mekanike të materialit plotësues,
- Dimensionet e materialit plotësues etj.

2.1.3. Teli për saldim dhe regjenerim me gaz

Teli për saldim me gaz - lloji, emërtimi, përbërja kimike, shmangiet, pamja e jashtme, dukuritë gjatë shkrirjes, metodat e ekzaminimit, mënyra e dërgesës, paketimi, garancioni etj., janë plotësisht të përcaktuara me norma dhe standarde përkatëse shtetërore apo ndërkombëtare.

Materiali plotësues që përdoret gjatë saldimit me gaz mund të jetë në formë të telit ose shufrës. Mirëpo, si teli, ashtu edhe shufrat, duhet të shkrihen lehtë dhe në mënyrë uniforme, nuk guxojnë të lirojnë gazra, sepse materiali në gjendje të lëngët do të shkumonte, do të spërkaste dhe do të fryhej. Nën atmosferën neutrale materiali duhet të jetë i qetë, të lidhet lehtë me materialin bazë, zgjyra duhet të notojë lehtë etj.

2.1.4. Elektrodat e mbështjella për saldim me hark elektrik me dorë

Elektrodat e mbështjella (fig. 2.3), përbëhen nga teli dhe mbështjellësi në të cilin mund të ketë masa organike dhe minerale të tjera, të cilat e ndihmojnë zhvillimin e procesit të saldimit. Mbështjellësi përbëhet prej elementeve, të cilat formojnë zgjyrë të rrjedhshme, ndihmojnë ndezjen dhe stabilizimin e harkut, bëjnë pastrimin, dezoksidimin, legurimin etj.





Fig. 2.3. Elektroda e mbështjell

Diametri i telit të elektrodave është: 1; 1,5; 2; 3; 3,25; 4; 5; 6; 8 dhe 10 mm.

Elektrodat me diametër deri 2,0 mm kanë gjatësinë 200, 300 dhe 400 mm, ndërsa të gjitha të tjerat kanë gjatësinë 350, 450 mm e më tepër.

2.2. Saldimi me metodën MIG /MAG

2.6.1.Saldimi me metodën MIG

Saldimi me elektrodë të shkrishme nën mbrojtjen e gazit inert (argoni, heliumi) bëhet rëndom në mënyrë gjysme automatike ose automatike, me elektrodë të pambështjellë në trajtë teli. Përpos funksionit të elektrodës teli e luan rolin edhe të materialit plotësues, i cili i jepet tegelit nën mbrojtjen e gazit inert, kryesisht argonit. Në figurën 2.4 është treguar aparati për saldim me metodën MIG/MAG.



Fig.2.4. Aparati për saldim nën mbrojtjen e gazit inert MIG-MAG.

Pasi që gazi inert nuk tretet në metalin e shkrirë, krijohen parakushtet për tegel cilësor, sepse si parakusht për saldim cilësor është mbrojtja e mirë e harkut nga veprimi i elementeve nga ajri në metalin e shkrirë dhe stabilitetin e harkut. Pra efikasiteti i mbrojtjes varet nga sasia e gazit, përkatësisht nga shpejtësia e rrjedhjes së tij. Shpejtësia e rrjedhjes varet nga parametrat e saldimit, konstruksioni i fërfillës dhe pozicioni i saldimit.

2.3. Saldimi me metodën MAG

Saldimi me hark elektrik nën mbrojtjen e gazit aktiv (CO_2) është një metodë që çdo ditë e më shumë po zëvendëson metodat tjera të saldimit me hark elektrik. Arsyeja për këtë është se gazi mbrojtës që përdoret në këtë metodë CO_2 është shumë më i lirë se sa i argonit dhe i heliumit, që përdoren te metoda MIG dhe TIG. Përdoret kryesisht për saldimin e çeliqueve të paleguruara, me legurim të lartë ose të metaleve të lehta, për shkak të veprimit të gazit me metalin e shkrirë.

Makinat dhe pajisjet që përdoren për saldim me metodat MIG dhe MAG janë pothuajse të njëjta. Dallimi qëndron në montimin e disa elementeve për kërkesa specifike si dhe në përdorimin e ndryshëm të gazit aktiv.

Materiali plotësues për saldim me metodën MIG/MAG është në formë teli dhe i mbështjellë në makara (fig.2.5).



Fig.2.5. Materiali plotësues-teli për saldim MIG-MAG.

2.4.Saldimi me metodën TIG

Metoda TIG, përdoret për saldimin e detaleve të çelikut, bakrit, aluminit, të legurave të tyre dhe metaleve të lehta. Metoda TIG, përdoret për saldimin e detaleve të holla, ndërsa për saldimin e detaleve me përmasa të mëdha përdoret metoda MIG.

Metoda TIG, përdoret më së tepërmi për saldimin e detaleve të holla, sepse materiali bazë nxehet më pak si dhe ndikimi është më i vogël në zonën kufitare të ndikimit të nxehtësisë. Deformimet dhe sforcimet që mbeten janë shumë më të vogla te bashkësitë e salduara me metodën TIG se sa te saldimi me metodën MIG ose me hark elektrik me dorë me elektrodë të mbështjellë.

Makinat dhe pajisjet për saldim me metodën TIG, mund të jenë të ndryshme. Ato dallojnë për nga zgjidhja konstruktive dhe mënyra e rregullimit të parametrave të regjimit. Në figurën 2.6 është paraqitëaparati për saldim me metodën TIG.



Fig.2.6. Pajisjapër saldim me metodën TIG.

3.0 VEÇORITË E KONSTRUKSIONEVE NGA ÇELIKU PËR ENË NËN SHTYPJE

3.1. Karakteristika e materialit bazë dhe plotësues

Materiali bazë për përpunimin e kaldajave në N.P.T. YLLITERM është çelik S235JR në formë pllake me trashësi 4mm, 5mm dhe 6mm. Përmasat standarde të pllakës janë (1500x6000) mm. Ky material përdoret për mbështjellës të kaldajave.

Materiali çelik PH265GH në formë pllake me trashësi 4mm, 5mm dhe 6mm. Përmasat standarde të pllakës janë (1500x6000) mm. Përdoret për vatra të kaldajës.

Materiali çelik PH265GH CTI në formë gypi pa tegel me trashësi të murit 3.6mm dhe gjatësi 6000 mm.

Materiali bazë është i porositur sipas karakteristikave të dhëna në standardin SK EN 10025-2 dhe standardit EN 10028-2:2009

Tab.3.1. Përmbajtja kimike e materialit bazë S235JR

PERBËRJA KIMIKE: (sipas standardit EN 10025-2)

	C%			Si%	Mn%	P%	S%	N%	Cu%
	Per trashësi ne mm								
	≤ 16	>16 ≤ 40	>40						
Nga	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Deri	0.17	0.17	0.20	-	1.40	0.035	0.035	0.012	0.55

VETIT MEKANIKE: (sipas EN 10277-2 standardit)

Qëndrueshmëria në tërheqje dhe zgjatimi specifik

Trashësia (mm)	Cilindruar (+SH)		Terhequr në të ftohtë (+C)		
	Fortësi HB	Rm (MPa)	Rp _{0.2} vlera minimale (MPa)	Rm (MPa)	A ₅ % vlera minimale
≥ 5 ≤ 10			355	470 - 840	8
> 10 ≤ 16			300	420 - 710	9
> 16 ≤ 40	102 - 140	102 - 140	260	392 - 690	10
> 40 ≤ 63	102 - 140	102 - 140	235	380 - 630	11
> 63 ≤ 100	102 - 140	102 - 140	215	340 - 600	11

Tab.3.2. Përmbajtja kimike e materialit bazë P265GH

C	Si	Mn	P	S
0.25 max	0.10 - 0.35	0.60 - 1.40	0.030max	0.030max
Cr*	Cu*	Mo*	Ni*	
0.25 max	0.30max	0.10max	0.30max	

Qëndrueshmëria në tërheqje dhe zgjatimi specifik

TRASHËSIA (mm)	KUFIRI I RRJEDHMËRISË (MPA)	QËNDRUESHMËRIA MAKSIMALE (MPA)	ZGJATIMI A%
deri në 16 mm	265 min	410 deri 530	22 min
16 deri 40 mm	255 min	410 deri 530	22 min
mbi 40 deri 60 mm	245 min	410 deri 530	22 min
mbi 60 deri 100 mm	215 min	410 deri 530	22 min
mbi 100 deri 150 mm	200 min	400 deri 530	22 min
mbi 150 deri 250 mm	185 min	390 deri 530	22 min

Me analiza është vërtetuar se materiali bazë e ka këtë përmbajtje kimike.

Hesteel Serbia Iron & Steel d.o.o. Beograd
 Balkanska 2a, 3 floor, apartment 3301,
 Beigrade- Stari grad, 11000 Serbia
 Republic of Serbia

INSPECTION CERTIFICATE 3.1 EN 10204:2004 /AD 2000-Merkblatt W 1
 -uverenje o ispitivanju-

PURCHASER: ATENIC COMMERCE D.O.O.
 (kupac) ČAČAK
 BULEVAR OSLOBODILACA 91
 TRADING CO: ATENIC COMMERCE D.O.O.
 (izvoznik, primalac) ČAČAK
 BULEVAR OSLOBODILACA 91
 PRODUCT: HOT ROLLED COILS
 (proizvod)
 DIMENSIONS: 5,000 X 1500 X
 (dimenzije, mm)
 QUALITY: P265GH / EN 10028-2/2009
 (kvalitet)
 Net Weight(kg): 23100
 DELIVERY CONDITIONS : N
 (STANJE ISPORUKE)

CERTIFICATE No: 59829
 (uverenje broj)
 UGOVOR KUPCA
 CONTRACT No. ATEN1106CS
 (ugovor broj.)
 T: HR+N+ADW
 - EN 10051/2010

PAGE No: 1
 (strana br)
 DATE OF ISSUE 24/10/2016
 (dat. izdavanja)

Transport: CA039PE

MECHANICAL PROPERTIES - MEH. TEH. OSOBINE											
COIL No,	Heat No!										
PACK No,	Šarža	Re	Rm	Re/	A	Impact test	Cold	Hardness	Melt		
(kotur br.)						Kv	bend!		Re/	furn!	
paket br)			Rm	Elo!	(žilavost)	test!	tvrdoca!	Elevat!			
				ing.	Sr.vr.	1	2	3	S	temp	inac.
		MPa	MPa			%	J	T°C	J	J	J
							180°	HRB	HV10	MPa	°C!

6G45012	858280	329	449	,73	39						
6G45013	858280	329	451	,72	36					242	300
										221	300

CHEMICAL COMPOSITION - HEMIJSKI SASTAV (%)												
HEAT No	C	Mn	Si	P	S	Al	Cu	Cr	Ni	Mo	Ti	V
Šarža												
br	X 100	X 1000			X 100			X 1000				
858280	14	83	200	14	5	37	1	1	<1	3	2	3
858280	14	83	200	14	5	37	1	1	<1	3	2	3

Measured values of alpha and beta/gamma surface contamination of the examined goods are for alpha emitters lower than 4 Bg/100cm², as well as for beta/gamma emitters lower than 40 Bg/100cm²
 We hereby declare that above mentioned products were manufactured in accordance with specifications and contract requirements.
 The manufacturer has a certified QA-system and has undergone a specific assesment as per PED 97/23/EC Annex I, sec.4.3.

QUALITY ASSURANCE
 OBEZBEDJENJE KVALITETA
 Hesteel Serbia Iron & Steel d.o.o.
 BEOGRAD
 Odeljenje za ateste
 AO-04

KOPIJA VERNA ORIGINALU


Hesteel Serbia Iron & Steel d.o.o. Beograd
Balkanska 2a, 3 floor, apartment 3301,
Belgrade - Starigrad, 11000 Serbia
Republic of Serbia



INSPECTION CERTIFICATE 3.1 EN 10204:2004
-uverenje o ispitivanju-

13
0045-CPR-0761

PURCHASER: ATENIC COMMERCE D.O.O. (kupac) ČAČAK BULEVAR OSLOBODILACA 91
TRADING CO: ATENIC COMMERCE D.O.O. (izvoznik, primalac) ČAČAK BULEVAR OSLOBODILACA 91
PRODUCT: HOT ROLLED COILS (proizvod)
DIMENSIONS: 6,000 X 1500 X (dimenzije, mm)
QUALITY: S235JR / EN 10025-2/2004 (kvalitet)
Net Weight(kg): 23600
DELIVERY CONDITIONS : AR (STANJE ISPORUKE)

CERTIFICATE No: 72490 (uverenje broj)
UGOVOR KUPCA
CONTRACT No. ATEN1116CS (ugovor broj.)
T: HR+CE
- EN 10051/2010

PAGE No: 1 (strana br)
DATE OF ISSUE 12/12/2016 (dat.izdavanja)
Transport: CA061YD

MECHANICAL PROPERTIES - MEH. TEH. OSOBINE											
COIL No,	Heat No	PACK No,	Re	Rm	Re/	A	Impact test	Bend	Hardness	Melt	
(kotur br. / paket br)	Šarža		MPa	MPa	MPa	MPa	Kv (žilavost)	test	(tvrdoća)	furn	
			MPa	MPa	MPa	MPa	ng. Sr. Vr. l 2 3 S			nacin	Proiz
			%	J	T°C	J	J	J	180°	HRB	HV10
6H64013	141707	293 432	,67	35							Y

CHEMICAL COMPOSITION - HEMIJSKI SASTAV (%)																
HEAT No	Šarža	C	Mn	Si	P	S	Al	Cu	Cr	Ni	Mo	Ti	V	Nb	N	Cev
br		X 100		X 1000				X 100			X 1000				X 100	
141707	13	77		12	10	9	42	5	2	2	5	1	2	1	6	26

Measured values of alpha and beta/gamma surface contamination of the examined goods are for alpha emitters lower than 4 Bg/100cm², as well as for beta/gamma emitters lower than 40 Bg/100cm²
We hereby declare that above mentioned products were manufactured in accordance with specifications and contract requirements.

QUALITY ASSURANCE
OBEZBEDJENJE KVALITETA
Hesteel Serbia Iron & Steel d.o.o.
BEOGRAD
Odeljenje za ateste
AO-04

HBIŠ GROUP Serbia Iron & Steel d.o.o. Beograd *
 Balkanska 2a, 3 floor, apartment 3301,
 Belgrade-Stari grad, 11000 Serbia
 Republic of Serbia

INSPECTION CERTIFICATE 3.1 EN 10204:2004
 -uverenje o ispitivanju-



13
 0045-CPR-0761

PURCHASER: ATENIC COMMERCE D.O.O. (kupac) ČAČAK
 BULEVAR OSLOBODILACA 91
 TRADING CO: ATENIC COMMERCE D.O.O. (izvoznik, primalac) ČAČAK
 BULEVAR OSLOBODILACA 91
 PRODUCT: HOT ROLLED COILS (proizvod)
 DIMENSIONS: 4,000 X 1500 X (dimenzije, mm)
 QUALITY: S235JR / EN 10025-2/2004 (kvalitet)
 Net Weight(kg): 23600
 DELIVERY CONDITIONS : AR (STANJE ISPORUKE)

CERTIFICATE No: 48199 (uverenje broj)
 UGOVOR KUPCA
 CONTRACT No. ATEN1067CS (ugovor broj.)
 T: HR+CE
 - EN 10051/2010

PAGE No: 1 (strana br)
 DATE OF ISSUE 28/06/2017 (dat.izdavanja)
 Transport: CA039PE

MECHANICAL PROPERTIES - MEH. TEH. OSOBINE															
COIL No,	Heat No											Impact test	Bend test	Hardness	Melt
(kotur br. / paket br)	Šarža	Re	Rm	Re/	A	Elo	Sr. Vr.			1	2	3	S	(tvrdoća)	furn
		MPa	MPa		%	J	T°C	J	J	J	J	180°	HRB	HV10	Proiz
7E51009	861463	319	402	,79	38										Y
7E51010	861463	319	402	,79	38										Y

CHEMICAL COMPOSITION - HEMIJSKI SASTAV (%)																
HEAT No	Šarža	C	Mn	Si	P	S	Al	Cu	Cr	Ni	Mo	Ti	V	Nb	N	Cev
br		X 100		X 1000		X 100		X 100		X 1000		X 1000		X 100		X 100
861463		8	46	14	10	4	36	1	1	<1	3	1	2	2	6	16
861463		8	46	14	10	4	36	1	1	<1	3	1	2	2	6	16

KOPIJA VERNIA ORIGINALA

Measured values of alpha and beta/gamma surface contamination of the examined goods are for alpha emitters lower than 4 Bg/100cm², as well as for beta/gamma emitters lower than 40 Bg/100cm²
 We hereby declare that above mentioned products were manufactured in accordance with specifications and contract requirements.

HBIŠ GROUP Serbia
 Iron & Steel d.o.o. Beograd
 Odeljenje za ateste
 AO-05

COD QC – 3.1 – Ed. 2 REV 5/2014



TMK-ARTROM S.A.

Draganesti Str. 30, Slatina, jud. OLT, Romania 230119
 Tel: +40 (249) 436862, 434640, 434641
 Fax: +40 (249) 434330, 437288
 E-mail: office.slatina@tmk-artrom.eu www.tmk-artrom.eu
 J 28/9/1991; VAT No. RO 1510210/1992
 Subscribed and Paid Share Capital: 291.587.538,34 lei

INSPECTION CERTIFICATE - EN 10204: 2004 / 3.1

No : E21009 Part I Page no.:1/1 Date: 23.12.2015						
Customer :				Order no. 15/24496/115/11/15		
Manufacturer: TMK ARTROM S.A. Manufacturer's mark:				Works no. 372023		Packing list no : 16956
Specifications techniques: PED 97/23/EC+ AD 2000W4 +EN 10216-2: 13						
Steel grade: P235GH TC1						
State of delivery: Heat treatment: normalized during hot rolling process, temperature between 880°C - 940°C and cooled in still air						
Description: Hot rolled seamless steel pipes; marking at both ends: manufacturer's mark, standard, steel grade, heat no., LOT, mill inspector no. 5, technical control sign; 115/11/15						
Item no.	Dimensions of tubes (mm)	Heat no.	Pcs.	Length - m	Weight - Kg	Billets producer
1.	76.1 x 3.6 x 6 000+100/-0	44124	262	1572.0	10510	TMK Resita S.A. ROMANIA

Additional remarks:
 The requirements are fulfilled as per **Annex 1- Test results**

MILL INSPECTOR
 UNTERSCHRIFT DES WERKSACHVERSTÄNDIGEN
 Eng. Constantin Lupu

Ausgestellt im Einvernehmen mit dem TÜV SÜD (02/98)
 Issued in agreement with TÜV SÜD (02/98)

The forgery of this certificate concludes to responsibility mentioned on Romanian Penal Code (art. 290-292).



THIS IS FOR CERTIFY THAT THE MATERIAL HEREIN DESCRIBED HAS BEEN MANUFACTURED WITH THE ORDERED SPECIFICATION AND THAT INFORMATION IS CORRECT. THEY MEET THE SPECIFICATION'S REQUIREMENTS AND ARE RECORDS IN OUR COMPANY DOCUMENTS.

KOPILA VERONA OBRATKALU

3.2. Përgatitja e detaleve për saldim

Përgatitja e kanalit

Paraprakisht është bërë përgatitja e kanalit të pllakave, ku për trashësi 4 mm pllakat janë pikuar në formen "I", ndersa për trashësi 5 mm dhe 6 mm pllakat janë përgatitur me rrëzimin e teheve në këndin 60° .



4.0 FAKTORËT QË NDIKOJNË NË CILËSINË E KONSTRUKSIONEVE TË SALDUARA

4.1. Faktorët për vlerësimin e saldueshmërisë

Faktorët për vlerësimin e saldueshmërisë janë të shumtë. Në varësi nga funksioni i bashkësisë së salduar, materiali bazë, plotësues, procesi i saldimit, etj, zgjedhën edhe faktorët për vlerësimin e sajë. Në vazhdim do të cekem faktorët e përdorur për vlerësimin e saldueshmërisë, nga autorët e ndryshëm botëror, e në varësi nga problemi, të cilit ju janë rrekur që ta zgjidhin.

Saldueshmërinë e materialit, gjatë procesit të saldimit mund ta përcaktojmë me ndihmën e këtyre faktorëve:

- me përbërjen kimike të materialit bazë;
- me strukturën paraprake dhe atë të fituar, dhe
- me konstruksionin fiziko-kimik të bashkësisë së salduar.

Saldueshmëria e çelikut me përbërje të zgjedhur dhe me veti mekanike të përcaktuara, përcaktohet me këta faktorë:

- shfaqjen e plasaritjeve të nxehta;
- shfaqjen e plasaritjeve të ftohta;
- egërsinë e krijuar në zonën e ndikimit të nxehtësisë, dhe
- çarjen lamelare.

Përshtatshmëria e çelikut që të saldohet varet nga:

- përbërja kimike e shprehur përmes ekuivalentit të karbonit;
- vetitë mekanike të materialit bazë (qëndrueshmëria në tërheqje, shtalbësi, këndi i prerjes etj.);
- rezistenca ndaj ndërrimit të këtyre vetive gjatë dhe pas saldimit;
- rezistenca ndaj shfaqjes së plasaritjeve të ftohta dhe të nxehta;
- rezistenca ndaj çarjes lamelare, dhe
- rezistenca ndaj shfaqjes së plasaritjeve gjatë përpunimit termik .

4.2. Cilësia e tegelave të salduar

Duhet te jetë në përputhje të plot me rregulloren për konstruksionet e çelikta bartëse te salduara Për konstruksione të rëndësishme plani i saldimit është pjesë e dokumentacionit teknik. Plani i saldimit duhet të përmbajë: procesin e saldimit, llojin e materialit plotësues, radhën e saldimit, cilësinë e prodhimit, kërkesat për prodhim dhe përpunimi, provat dhe mënyrën e kontrollimit të tegelave të salduara. Ekzistojnë tri lloje të cilësisë së tegelit:

1. Cilësia speciale “S”,
2. Cilësia “T” dhe
3. Cilësia “II”.

Tegelat me cilësi speciale duhet të jenë:

- Të mirë dhe pa plasaritje,
- Pa gabime në fillim dhe në mbarim të tegelit,

- Me rrënjë të pastër dhe të salduar mirë,
- Pa kanale (prerje) dhe pa mbi lartësi të fytyrës
- I shndritshëm për gjatë gjatësisë.

Gjatë prodhimit të konstruksioneve dhe përgatitjes së detaleve për saldim sipas rregullave bëhet shënimi me ngjyrë dhe atë:

- Me ngjyrë të verdhë – cilësia S,
- Pa ngjyrë – cilësia “I” dhe
- Me ngjyrë të kaltër – cilësia “II”




Fig.4.1. Shënimi i cilësisë së tegelave

Shënimi i cilësisë së tegelave bëhet sipas standardit përkatës dhe në përputhje me paraqitjen e tegelave në vizatim. Kur parashihet ndonjë kontroll i tegelave të salduar: radiologjik, ultratingull, magnetik ose ndonjë tjetër duhet të formohet plani me të cilën duhet të shënohen vendet dhe vëllimi i kontrollit. Për konstruksione të çelikut bartëse të salduara përdoren çelikut përkatës për material plotësues përdoret: elektroda për saldim me hark elektrik, teli për saldim me gaz, teli për saldim me metoda tjera, shiritat etj. Këto materiale plotësuese janë të standardizuara.

4.3. Shënimi i tegelave

Paraqitja e tegelave në saldim bëhet sipas standardit ISO 2553. Tegelat shënohen në përputhje me rregullat e vizatimit teknik.

Çdo lloj i tegelit ka simbolin e vetë të caktuar. Paraqitja e plotë e tegelave në vizatim është dhënë në figurën vijuese dhe përbëhet prej:

- Shigjetës (1),
- Vijave treguese (2),
- Shenjës së tegelit (3)

Vija treguese përbëhet prej dy vijave paralele (2a) dhe të ndërprera (2b). Vija e ndërprerë e cila mund të jetë mbi ose nën vijën e pandërprerë tregon se në cilën anë të shigjetës gjendet fytyra e tegelit. Nëse tegeli është simetrik vija nuk vizatohet




Fig. 4.2. Shënimi i tegelave:
1-shigjeta; 2-vijat treguese; 3 - shenja numerike




Fig. 4.3. Paraqitja e vendeve të simboleve:a-tegeli simetrik; b-fytyra e tegelit është në anën e shigjetës c-fytyra e tegelit është në anën e kundërt të shigjetës




Fig.4.4. Shënimi i tegelave; 1 - shigjetat; 2 - vijat treguese; 3 - shenjat e tegelit

TAB. 4.1. SHENJA THEMELORE DHE PLOTËSUESE E TEGELAVE

Shenja themelore		Shenja plotësuese	
Emërimi i tegelit	Simboli	Sqarim	Simboli
Tegeli - I		Rrënja e salduar	○
Tegeli - V	∇		
Tegeli - V me nënshtrësë	∇	Fytyra ose rrënja e përpunuar	
Tegeli - Y	Y		
Tegeli - X	X	Tegeli këndor kontinual	⚡
Tegeli - U	∩		
Tegeli - U i dyfishtë	∩	Fytyra e rrafshët e tegelit këndor	⚡
Tegeli - 1/2 V	∇		
Tegeli - K	K	Fytyra konvekse e tegelit këndor	⚡
Tegeli J	J		
Tegeli këndor	∇	Fytyra konkave e tegelit këndor	⚡
Tegeli këndor i dyfishtë	∇		
Tegeli në kënd	∇	Tegeli këndor i salduar përgjatë tërë konstruksionit	⊙
Tegeli pikëzoz	○		

Mënyra e paraqitjes së shenjës së kombinuar është treguar në Figurën e radhës,




Fig.4.5. Paraqitja e kombinuar: a – shenja, b – prerja tërthore e tegelit

Ndërsa shënimi i përmasave të tegelit në vijim




Fig.4.6. Shënimi i përmasave të tegelit

Përveç këtyre ekzistojnë edhe shenja të tjera plotësuese:

- Rrethi, tregon se saldimi bëhet përreth detalit (a).
- Flamuri, tregon tegelin montues (b).
- Vlera numerike që tregon shenjën e metodës së saldimit




Fig.4.7. Shenjat plotësuese: a) rrethi – tegeli i salduar përreth tërë detalit, b) flamuri – tegeli montues, c) vlera numerike që tregon metodën e saldimit (111 – saldimi me hark elektrik me dorë me elektrodë të mbështjellur).

4.3.1. Përgatitja e detaleve nga çeliku dhe shënimi i tegelave në konstruktionin e kaldajës




Fig.4.8.Kutia e tymit për kalda 25 kW




Fig.4.9.Vatra e kaldajës 25 kW




Fig.4.10. Prerja e kaldajës 25 kW




Fig. 4.11. Kutia e tymit për kalda 350 kW

A-A (1 : 15)




Fig.4.12.Tërësia e kaldajës 350 kW




Fig. 4.13. Vatra e kaldajës 350 kW

5.0. KONTROLLI I CILËSISË SË KONSTRUKSIONEVE TË SALDUARA

Cilësia e tegelave të bashkësive të salduara bëhet përmes kontrollit të tegelave me metodat me shkatërrim dhe pa shkatërrim, cilësia e çdo prodhimi mund të përkufizohet si grumbullim i të gjitha vetive dhe veçorive të prodhimit (bashkësisë së salduar) që kanë të bëjnë me mundësinë e plotësimit të kërkesave të bëra nga konsumatorët, pastaj prodhimet tjera të cilat i bëjnë për nevoja tona etj. Metalet dhe lidhjet e tyre janë materialet kryesore që përdoren në inxhinieri. Këto karakterizohen me përbërje të ndryshme kimike, veti të ndryshme fizike, mekanike, teknologjike dhe me veti të tjera që përcaktohen me metoda të ndryshme të provave.

Provat e metaleve zakonisht ndahen në dy grupe:

- **Provat me shkatërrim, dhe**
- **Provat pa shkatërrim**

Pjesa apo detali makinerik i cili provohet me prova me shkatërrim, zakonisht shkatërrohet, prandaj edhe nuk mund të përdoret më si i tillë.

Pjesa apo detali makinerik i cili provohet me prova pa shkatërrim, nuk shkatërrohet, prandaj edhe ai mund të përdoret edhe pas provave. Prandaj provat pa shkatërrim janë shumë më të përshtatshme për provat e detaleve të gatshme.

Me prova të vetive kimike përcaktohen: përbërja kimike, mikrostruktura, rezistenca ndaj ndryshkut, ndezshmëria, vetitë toksike. Me prova fizike përcaktohen: dendësia, ngjyra, masa, temperatura e shkrirjes, përcjellshmëria e nxehtësisë, përçueshmëria elektrike dhe vetitë e tjera elektrike, magnetike, optike dhe akustike. Provat mekanike kanë për qëllim përcaktimin e vetive të metaleve që janë të varura nga veprimi i forcave në to: qëndrueshmëria, elasticiteti, plasticiteti, fortësia, shtalbesi, lodhja, rrëshqitja. Përdorimi i madh i materialeve metalike me qëllim të prodhimit të konstruksioneve të ndryshme është rezultat i qëndrueshmërisë së lartë dhe i plasticitetit të mirë, përkatësisht i vetive të mira mekanike.

Varësisht nga mënyra e veprimit të forcave, lloji i ngarkesës dhe kushtet në të cilat bëhen provat, provat mekanike mund të ndahen në shumë mënyra:

Sipas mënyres së veprimit të ngarkesave, provat mekanike ndahen në:

- Prova në tërheqje
- Prova në shtypje
- Prova në lakim
- Prova në përdredhje dhe
- Prova në prerje.

Sipas mënyrës së veprimit të forcës mund të ndahen në:

- Prova statike, dhe
- Prova dinamike.

Provat statike bëhen me veprim të njëtrajtshëm të forcës ose me rritje të shkallëzuar të forcës. Shpejtësia e veprimit të forcës zakonisht duhet të jetë më e vogël se $10 \text{ N/mm}^2 \cdot \text{s}^{-1}$ (MPa/s). Te provat dinamike përdoret forca goditëse ose forca e cila ndryshon në mënyrë alternative me kohën (*ndryshimi periodik i forcës* ose *ndryshimi i rastësishëm i forcës*).

Me prova teknologjike përcaktohet aftësia e materialit për tu përpunuar me njërin nga metodat e përpunimit të metaleve (përpunim me prerje, saldim, përpunim me deformim plastik, derdhje etj.). Provat defektoskopike kanë për qëllim zbulimin e gabimeve në materiale dhe në detale.

Varësisht nga temperatura në të cilën kryhen provat ato mund të ndahen në tri grupe:

- Prova në temperaturë normale
- Prova në temperatura të larta, dhe
- Prova në temperatura të ulëta.

5.1. Metodatat e kontrollit pa shkatërrim

Kontrolli i saldimit bëhet në tri faza: para se të fillojë saldimit, gjatë saldimit dhe pasi të mbarojë saldimit.

Kontrolli para se të fillojë saldimit – në këtë fazë bëhet kontrollimi i përgatitjes së teheve – kanalit, kontrollimi i bashkësisë në tërësi, kontrollimi masave tëduhura që të mos shkaktohet deformimi i konstruksionit, masave të nevojshme për zvogëlimin e sforcimeve të mbetura, kontrolli i nxehjes paraprake, bazimit, nivelizimit, mjeteve, masave mbrojtëse, etj.

Kontrollimi gjatë procesit të saldimit – në këtë fazë bëhet kontrollimi i parametrave të regjimit të saldimit (intensiteti i rrymës, tensioni i harkut, shpejtësia e saldimit, etj), i materialit ndihmës dhe plotësues, kontrollimi i teknikës së saldimit, etj.

Kontrollimi pasi të mbarojë saldimit – në këtë fazë rëndomë bëhet kontrollimi vizual, në të shumtën e rasteve edhe kontrollimi me shkatërrim dhe pa shkatërrim.

Metodat pa shkatërrim ndahen kryesisht në: metoda vizuale, metoda me rrezatim, metoda me ultratingull, metoda magnetike, metoda kapilare, etj.

Të gjitha këto metoda kanë disa variant të përdorimit, të cilat dallohen në mes veti.

Secila metodë ka përparësitë se ku mund të përdoret, për çfarë forma dhe ndërlikueshmëri të detaleve, për çfarë sipërfaqesh dhe trashësie, etj.

5.1.1. Kontrolli Vizual

Kontrollimi vizual bëhet para saldimit, gjatë saldimit dhe pas saldimit. Ky kontrollim përfshin kontrollimin e formës dhe të përmasave të materialit bazë si dhe gjendjen sipërfaqësore të detaleve, kontrollimin e formës dhe dimensioneve të tegelit të salduar e posaçërisht të fytyrës dhe të rrënjës së tegelit, etj.

Përveç këtyre kontrollimeve, me kontrollim vizual përfshihet edhe kontrollimi i konstruksionit si tërësi, që d.m.th, kryerja e të gjitha tegelave sipas procesit teknologjik.

Për realizimin e një kontrollimi të tillë përdorën vegla dhe pajisje të formave dhe të dimensioneve të ndryshme për kontrollimin e trajtës së kanalit dhe formës së tegelit, zmadhues të ndryshëm, etj.

Nga figurën 5.1 është paraqitur kontrollvizual i tegelave të salduar.




Fig.5.1.Kontrollvizual: a- tegeli i salduar jo ne rregull, b- tegeli i salduar mirë

5.1.2. Prova me rreze “X” (Röntgen)

Rrezet iks janë valë elektromagnetike me gjatësi valore prej $5 \cdot 10^{-7} \text{mm}$ deri $0.01 \cdot 10^{-7} \text{mm}$ dhe me frekuencë $5 \cdot 10^{15}$ deri $5 \cdot 10^{21} \text{Hz}$.

Valët me gjatësi valore më të madhe se $0.01 \cdot 10^{-7} \text{mm}$ quajmë rreze te buta iks “ X ”, ato me valë më të shkurtra, të forta. Sa më të forta që të jenë rrezet, më lehtë depërtojnë nëpër material dhe absorbohen më pak.

Rrezet iks përfitohen nga gypi i kuiligit, ato edhe përdoren më së shumti për kontrollimin e materialit, sepse:

a – kanë veti që thyhen dhe të reflektohen në kristale, pra me to mund të zbulohen edhe gabimet në mes të kristaleve (interkristalore) dhe në vetë kristale.

b – kanë veti që materialet me dendësi të vogël i absorbojnë më pak se sa ato të dendurat.

Rrezet röntgen që burojnë prej burimit pikëzorzgjerohen në mënyrë drejtvizore, kalojnë nëpër material deri në pllakën fotografike apo fluoreshente me intensitet të ndryshëm, në varësi nga materiali e trajta dhe përmasat e gabimit.

Kështu pra zbulohen gabimet në brendinë e materialit bazë ose në tegelin e salduar, që janë: poret, plasaritjet, zgjyra, etj. Plasaritjet shumë të imëta (mikroplasaritjet) nuk mund të zbulohen në mënyrë të sigurtë.



Fig.5.2.Prova me rreze "X" (rëntgen), pajisja për provë me rreze "X"




Fig.5.3. Gabimet e identifikuara me kontrollë me rreze "X"

5.1.3. Prova me rreze gama

Sipas natyrës që kanë edhe rrezet gama janë rreze elektromagnetike sikurse rrezet "X", por me gjatësi valore $0,2 \cdot 10^{-7}$ deri $0,001 \cdot 10^{-7}$ mm dhe me frekuencë deri në 10^{24} Hz.

Rrezet fitohen nga elementet radioaktive ose izotopet radioaktive. Për provën me rreze gama më së tepërmi përdoren këto izotope:

- 1 - Kobalti 60 për materiale me trashësi 15-25 mm.
- 2 - Iridiumi 192 për çelik me trashësi 10-35 mm,
- 3 - Ceziumi 137 për çelik me trashësi 12-60 mm.
- 4 - Taliumi 170 për materiale të holla.

Përgatitja e tegelit për kontrollim me rreze gama është treguar në figurën 5.4, ndërsa figura e gabimit të materialit fitohet në pllakën fotografike në figurën 5.5.

Prova radiografike me rreze gama është e ngjashme me provën me rreze iks "X". Dallimi qëndron vetëm në aparat, i cili bën emetimin e rrezeve.

Kërkesë kryesore e aparatit është që ai të jetë i sigurt për manipuluesin (punëtorin) dhe për rrethin, sepse shumë lehtë mund të ndodhë rrezatim, i cili është shumë i dëmshëm. Në figurën 5.6 është paraqitur pajisja për kontrollim me rreze gama.




Fig. 5.4. Përgatitja e tegelit për kontrollim me rreze gama: 1-burimi i rrezeve gama; 2-tegeli; 3-treguesi i cilësisë së fotografisë; 4- filmi; 5-mbrojtësi prej plumbi




Fig. 5.5. Kontrollimi me rreze gama: 1-burimi i rrezeve; 2-materiali; 3-gabimi; 4-filmi;



Fig. 5.6. Pajisja për provë me rreze gama: a-pajisja; b-transportuesja e izotopeve; c-pajisja complete; d-pajisja e vendosur në trekëndëshin statik.

5.1.4. Kontrolli me ultratingull

Me ultratingull mund të përcillen energji shumë më të mëdha, me të cilat mund të zbulohen gabimet në material.

Ultratingulli fitohet në mënyra të ndryshme. Për kontrollin e bashkësive të salduara më së tepërmi përdoret efekti piziotmetrik i kuarcit d.m.th., deformimi i tij nën ndikimin e fushës elektrike. Nëse në kristalin e kuarcit ndikon rryma elektrike alternative, ai bëmehet e tkurret me frekuencë të njëjtë me atë të rrymës elektrike. Kështu formohen dridhjet mekanike – ultratingulli.

Ultratingulli përcillet në bashkësinë e salduar, duke e puthitur mire sondën për sipërfaqen e lyer të materialit. Për shkak se ultratingulli depërton mire në material, atëherë kur intensiteti është i madh, ai depërton deri në anën tjetër të materialit, dhe prapë do të kthehet (shih figurën 5.7).




Fig. 5.7. Paraqitja skematike e provës me ultratingull

Në këtë mënyrë kemi mundësi të caktojmë edhe trashësinë e materialit.

Në vendet ku gjendet gabimi ultratingulli do të kthehet (reflektohet), dhe në ekran do të paraqitet në formë të një lakoreje të ngritur (kodre) që quhet **eho**, pra impulse që depërton në material nëse gjatë rrugës së tij hasë në ndonjë pengesë (gabim) atëherë ajo do të kthehet në sondë e cila bënë regjistrimin e valëve dhe i shëndrron drejtpërdrejtë ne impulse që paraqitën në ekranin e aparatit.

Në figurën 5.8 është paraqitur aparati për kontroll me ultratingull dhe kontrollimi i gypit.



Fig.5.9.Dhe aparati KRAUTKRAMER USN 52L për provën me ultratingull dhe sondat e ultratingulli (kokat)

5.1.5. Metodät elektromagnetike

Metodat elektromagnetike ndahen në dy grupe:

1. Metodät që shfrytëzojnë pasojat e ndikimit të forcës magnetike të prodhuar në detalin e magnetizuar, që kontrollohet dhe,
2. Metodät që shfrytëzojnë veprimin induktiv të forcës magnetike, të rrymës alternative.

Me metodën e parë mund të kontrollohen vetëm metalet magnetike, e me të dytën edhe ato jomagnetike.

Materialet që mund të magnetizohen (giza e hirtë e çeliku) lyhen me vajë të rrallë (vajguri) në të cilin derdhet pluhuri metalik që mund të magnetizohet. Në materialin homogjen, formohet fusha magnetike me intensitet (force) konstante.

Pluhuri magnetik që ndodhet në vajë shpërndahet njëtrajtshëm. Çdo gabim (johomogjenitet) në material (poret, plasaritjet, mbeturinat jometalike) qoftë edhe me e imta si p.sh. plasaritjet që nuk mund të vërehen me sy, ndikojnë në fibrat (vijat) e fushës magnetike, në dendësinë e saj, kështu gabimi zbulohet në bazë të shtresimit të grimcave të pluhurit metalik. Grimcat metalike nuk shtresohen vetëm atëherë kur gabimi ndodhet në sipërfaqen e materialit, por edhe në brendinë e tij d.m.th. nën sipërfaqe.

Materiali, i cili provohet, vendoset në mes të poleve të elektromagnetit, nëpër dredhat e të cilit kalon rryma alternative ose e vazhduar (fig. 5.10). Fusha elektromagnetike devijon më tepër kur gabimet në material ndodhen të vendosura në mënyrë të tërthortë ndaj kahut të fushës magnetike, se sa atëherë kur ndodhen në kahe të njëjtë me gabimin. Për këtë arsye fusha elektromagnetike përherë duhet të induktohet ashtu që ajo të veprojë tërthorazi në gabim.




Fig.5.10. Zbulimi i gabimeve me metodën magnetike:
 1-bashkësia e salduar; 2-gabimi në tegel;
 3-vendtubimi i thërrmijave metalike; 4-elektromagneti;
 5-fibrat e fushës magnetike; 6-pluhuri i imët i shpërndarë në vaj;
 7-burimi i rrymës njëkahore.

5.1.6. Kontrolli me penetrant (Lëng kapilar)

Prova bazohet në vetitë kapilare të lëngjeve që të depërtojnë në thellësi, të cilat në praktikë njihen me emrin penetrante. Lëngjet e këtilla kanë veti që të depërtojnë (futen) në gabime (zbrazëti, plasaritje, mikroplasaritje, etj), që nuk mund të shihen me sy. Qëllimi kryesor i provës me penetrant është zbulimi i plasaritjeve të materialit, të cilat lindin për shkak të procesit teknologjik të përpunimit (saldimit, derdhjes, përpunimit termik) dhe për shkak të kushteve të eksploatimit (lodhja, ndryshkja, etj).

Duhet theksuar se prova me penetrant bënë zbulimin e gabimeve sipërfaqësore, d.m.th. të atyre gabimeve të cilat kanë dalje në sipërfaqe. Gabimet në thellësi të materialit nuk mund të zbulohen me këtë metodë.

Për realizimin e provës me penetrant, përveç penetrantit duhet të kemi edhe: zhvilluesin, pastruesin dhe burimin e dritës. Sot prodhohen penetrant të ndryshëm të cilët hedhen në sipërfaqe me anë tëbrushës, me stërpikje, në formë të aerosolëve dhe me zhytjen e materialit në kaden e mbushur me penetrant.



Fig.5.11. Prova me penetrant (lëng kapilar) dhe matja e gabimit

Plasaritjet sipërfaqësore duhet të shikohen me dritë ultravjollce, gjerësia me e vogël e gabimit që zbulohet është 0.01 mm , ndërsa thellësia më e vogël 0.03 mm.

Në fig 2.12. është paraqitur mënyra e zbulimit të plasaritjes të tegelit të salduar të gypave.



Fig.5.12. Zbulimi i plasaritjeve te tegelit te salduar të gypave me metodën penetruese

5.2. Gabimet në bashkësitë e salduara

Cilësia e bashkësisë së salduar vlerësohet përmes gabimeve të saldimit, qëndrueshmërisë, strukturës së metalit të tegelit dhe zonës së ndikimit të nxehtësisë etj. Në cilësinë e bashkësisë së salduar ndikon zgjedhja e drejtë e materialit bazë dhe plotësues, përgatitja e përshtatshme e kanalit, përdorimi i pajisjes së nevojshme, përgatitja e nevojshme profesionale e saldatorëve etj. Çdo gabim, sado i vogël, që lajmërohet në bashkësinë e salduar dukshëm ndikon në vetitë mekanike, homogjenitetin, stabilitetin, sigurinë, funksionalitetin dhe eksploatimin.

Teknologjia bashkëkohore nuk siguron çdo here prodhim të bashkësisë së salduar pa gabime. Ekzistojnë shumë faktorë, të cilët ndikojnë në lajmërimin e gabimeve në bashkësinë e salduar, siç janë:

- Saldueshmëria e ulët e materialit bazë
 - Materiali i papërshtatshëm plotësues
 - Metoda e papërshtatshme e saldimit
 - Mangësitë në përgatitjen e bashkësisë
 - Përvoja e pamjaftueshme e saldatorit etj
-
- Klasifikimi i gabimeve në bashkësinë e salduar

Gabimet në bashkësinë e salduar sipas rekomandimit të Institutit Ndërkombëtar të Saldimit (IIW=International Institute of Welding) klasifikohen në gjashtë grupe tab.5.2.2.

Tab.5.2.1. PASQYRA E SHKAKTARËVE TË GABIMEVE DHE MASAT PËR ELIMINIMIN E TYRE

Shkaqet për shfaqjen e gabimeve	Masat për eliminimin e gabimeve
PLASARITJET	
<p>-metali që vështirë saldohet përkatësisht nën kushte të caktuara materiali është i saldueshëm por ato nuk janë mbajtur gjatë kohës së saldimit</p> <p>-zgjedhja jo e drejtë e materialit plotësues</p> <p>-sforcimet e brendshme shumë të mëdha për shkak të ngurtësisë së lidhjes</p> <p>-lajmërimi i hidrogjenit në metalin e shkrirë</p> <p>-parametrat joadekuatë të saldimit, etj</p>	<p>-zgjedhja e drejtë e materialit plotësues</p> <p>-zgjedhja dhe ruajtja e parametrave të saldimit</p> <p>-respektimi i radhës së saldimit</p> <p>-paranxehja, ftohja e ngadalshme dhe përpunimi termik eventual</p> <p>-pamundësimi i pranisë së hidrogjenit në materialin plotësues dhe metalin e tegelit</p> <p>-pastrimi i sipërfaqeve që saldohen, etj</p>
PORET E GAZIT, ZBRAZTËSITË, FLLUSKAT E GAZIT	
<p>-lajmërimi i papastërtive në sipërfaqe të detaleve</p> <p>-lagështia në materialin bazë dhe plotësues</p> <p>-zgjedhja joadekuatë e intensitetit</p> <p>-mbeturinat e ngjyrës në materialin bazë, etj</p>	<p>-zgjedhja dhe ruajtja e parametrave të saldimit</p> <p>-pastrimi i papastërtive nga sipërfaqja</p> <p>-përdorimi i elektrodave të terura</p> <p>-paranxehja e detaleve, etj</p>
MBETURINAT NË GJENDJE TË NGURTË	
<p>-pastrimi i dobët i zgjyrës nga shtresa e mëparshme e tegelit</p> <p>-teknika joadekuatë</p> <p>-intensiteti i ulët i rrymës</p> <p>-diametri i madh i elektrodës së përdorur, etj.</p>	<p>-përdorimi i elektrodave me diametër përkatës</p> <p>-zgjedhja dhe ruajtja e parametrave të saldimit</p> <p>-largimi i zgjyrës nga shtresa e mëparshme</p> <p>-përdorimi i teknikës përkatëse</p> <p>-mbajtja e zgjyrës mbi hark elektrik me anë të rregullimit të këndit të elektrodës</p> <p>-pastrimi i mirë i vazhdimeve të tegelit, etj.</p>

PËRNGJITJA DHE SHKRIRJA E PAMJAFTUESHME

<p>-teknika joadekuate-parametrat joadekuatë të saldimit</p> <p>-lajmërimi i papastërtive në sipërfaqe të detaleve</p> <p>-përgatitja e dobët e bashkësisë</p> <p>-zgjedhja e gabuar e diametrit të elektrodës</p>	<p>-përdorimi i elektrodave me diametër përkatës</p> <p>-zgjedhja dhe ruajtja e parametrave të saldimit</p> <p>-përdorimi i teknikës përkatëse-pastrimi i mirë i sipërfaqeve, etj.</p>
GABIMET E FORMËS	
<p>-teknika joadekuate</p> <p>-parametrat joadekuatë të saldimit</p> <p>-zgjedhja e gabuar e diametrit të elektrodës</p> <p>-masa e pamjaftueshme e metalit të deponuar</p>	<p>-përdorimi i elektrodave me diametër përkatës</p> <p>-zgjedhja dhe ruajtja e parametrave të saldimit</p> <p>-përdorimi i teknikës përkatëse</p> <p>-shpejtësia adekuate e saldimit, etj</p>
GABIMET E TJERA	
<p>-kryesisht pakujdesi i saldatorit</p>	<p>-të shtohet kujdesi gjatë punës</p>

Tab.5.2.2. GABIMET NË BASHKËSINË E SALDUAR

Grupi	Shenja bazë	Lloji i gabimit
1	100	Plasaritjet
2	200	Poret e gazit,zbrazësitë,fluskat e gazit
3	300	Mbeturinat në gjendje të ngurtë
4	400	Përngjitja dhe shkrirja e pamjaftueshme
5	500	Gabimet e formës
6	600	Gabimet e tjera

5.2.1. Plasaritjet

Janë gabimet me të rrezikshme në bashkësinë e salduar, për shkak të ndërprerjes së kontinuitetit të metalit, më ç'rast ndodh lajmërimi i sforcimeve.

Dallojmë dy lloje plasaritjesh, ato që lajmërohen në temperaturat e larta dhe quhen plasaritje të nxehta dhe plasaritje që lajmërohen pas ftohjes së plotë të bashkësisë së salduar që quhen plasaritje të ftohtë.

Sipas standardit plasaritjet janë të ndara në: mikroplasaritje, plasaritje gjatësore, tërthore, në formë ylli, grup plasaritjeve të shpërndara dhe plasaritjeve të degëzuara.

Plasaritjet mund të lajmërohen (shfaqen) në metalin e tegelit, në zonën e ndikimit të nxehtësisë dhe në metalin bazë.

Sipas standardit plasaritjet shënohen: p.sh. plasaritjet gjatësore, të cilat shfaqen në drejtim të bushtit të tegelit, shënohen 101, plasaritjet tërthore shfaqen në drejtim normal në boshtin e tegelit dhe shënohen 102.

Plasaritjet mund të ndodhin për shkak të saldueshmërisë së ulët të metalit, përkatësisht për shkak se gjatë kohës së saldimit kushtet e parapara kanë ndryshuar, pastaj për shkak të zgjedhjes joadekuate të materialit plotësues, sforcimeve të brendshme të mëdha si pasojë e shtrëngimit të kufizuar të detalit (ngurtësisë së bashkësisë), lajmërimi i oksigjenit në metalin e tegelit etj.




Fig.5.13. Plasaritjet gjatësore dhe tërthore të identifikuar përmes aparatit radiografik

